

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-100/13**

**Prishtinë**

**17 tetor 2013**

Në çështjen juridike të

**B.V**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

kundër

**I.I**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/164/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 10790), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 tetor, mori këtë

## AKTGJYKIM

- 1- **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 10790), i datës 5 shtator 2012 dhe hedhet poshtë në kërkesa për pronën private në mungesë juridiksioni.**
- 2- **Obligohet B.V që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.**

Më 12 dhjetor 2006, B.V, si anëtar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore Petko Vujović (i ati i paraqitësit të kërkesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, ku ka kërkuar kthimin në posedim të ngastrës nr. 661 në Baush të Muhaxherëve, Lipjan. P.V kishte vdekur më 11 shtator 1983. Sipas fletës poseduese nr. 9, e tërë prona është e regjistruar në emër të P.V.

I.I ka paraqitur përgjigje në kërkesë, e cila nuk ka datë. Në deklaratën e datës 18 gusht 2008, ai ka deklaruar se pronën e kishte blerë nga P.V në vitin 1976. Ai nuk kishte mundur që ta regjistronte blerjen, sepse P.V e kishte ndërruar adresën e tij. I. më vonë kishte kuptuar se P.V kishte vdekur në vitin 1983. I. pohon se kishte pagur tërë shumën për pronën në fjalë. Në një deklaratë të mëvonshme të datës 20 gusht 2011, I. ka deklaruar se pronën e kishte blerë në vitin 1977 dhe se në atë pronë i kishte ndërtuar dy shtëpi në vitin 1980 dhe 1992.

Në një deklaratë të vitit 2012, B.V konfirmon se prona i ishte shitur në vitin 1978 to SH.L. Megjithatë, B.V pohon se çmimi i blerjes asnjëherë nuk ishte paguar në tërësi dhe për këtë arsye kontrata nuk ishte nënshkruar dhe regjistruar. B.V kërkon nga AKP-ja që të vërtetojë se shitësi, i përfaqësuar nga trashëgimtarët e tij ligjor, ka të drejtën e kërimit të borxhit të mbetur.

Në vendimin grupor të datës 5 shtator 2012, në faqen 20 nën titullin “Kërkesa nr. 10790”, KKPK-ja e kishte refuzuar kërkesën e B.V, duke cekur se pronari i supozuar i pronës e kishte shitur vullnetarisht atë para konfliktit të viteve 1998-1999, dhe prandaj ai nuk ka arritur që të tregojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore ndaj pronës së kërkuar para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.

Vendimi i është dorëzuar B.V më 3 prill 2013. Ai ka paraqitur ankesë më 22 prill 2013. Ankesa i është dorëzuar I. më 3 korrik 2013, i cili nuk është përgjigjur brenda afatit prej 30 ditëve.

Ankesa është paraqitur nga avokati D.A.V, i cili ka paraqitur edhe autorizimin për të vepruar në emër të B.V në këtë rast. Në ankesë ceket se KKKPK-ja ka gjetur gabimisht se Islami ishte pronar i pronës në bazë të “deklaratave të certifikuara të dy dëshmitarëve”. Këta dëshmitarë duhet të intervistohen në një procedurë ligjore, ku B.V do t’i mundësohej të bënte pyetje. Për më tepër, në ankesë theksohet se nuk është paraqitur asnjë kontratë apo provë me shkrim në lidhje me shitblerjen, prandaj pretendimi për kontratë është jo bindës apo i paligjshëm. Ankesa nuk cek se deklaratat e mëhershme e B.V lidhur me shitblerjen e pronës dhe mungesën e pagesës së plotë ishin të pasakta.

### **Arsyetim ligjor.**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda fatit prej 30 ditësh të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai tani nuk është në gjendje që t’i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Sipas nenit 2 – Parimet e përgjithshme, pika 2.1 të Urdhresës Administrative 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 “Çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejta tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”.

Tekstet demonstrojnë qartë se qëllim i këtij ligji të veçantë (rregulloreje) është që të sigurojë kthimin e të drejtave pronësore të cilat nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

Ky ligji i veçantë nuk shërben për zgjidhjen e pronës tradicionale dhe kontesteve që ndërlidhën me pronën, të cilat në asnjë mënyrë nuk janë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur. Ato konsiderohet se do të zgjidhen në kuadër të kornizës së legjislacionit të përgjithshëm ekzistues për pronësinë, siç është për shembull Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154 i vitit 2009, GZ. nr. 57/2009).

Në rastin aktual, nuk është e kontestueshme se një marrëveshje për shitblerjen e pronës së kontestuar ishte arritur në pjesën e dytë të viteve të shtatëdhjeta. Palët kanë mospajtime rreth kushteve të marrëveshjes, nëse shitja dhe çmimi i shitëblerjes është paguar ose jo. Përveç kësaj, B.V deklaron se babai i tij ia kishte shitur pronën SH.L, ndërsa I. pohon se pronën e kishte blerë nga i ati i B.V. Ky është një kontest që duhet të zgjidhet nga gjykatat e rregullta.

Po ashtu nuk është e kontestueshme se I. i kishte ndërtuar dy shtëpi në pronë në vitin 1980 dhe në vitin 1992.

Prandaj, kontesti nuk është i ndërlidhur apo nuk ka rezultuar nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Pas shqyrtimit të meritave të lëndës, KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, KKPK-ja nuk ka juridiksion mbi lëndën sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Prandaj, Gjykata Supreme e ka anuluar vendimin e KKPK-së dhe e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit.

Ky vendimi i Gjykatës nuk e paragjykon të drejtën e B.V për të kërkuar konfirmimin e së drejtës së tij pronësore pranë autoriteteve kompetente vendore.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore i paraparë më Ligjin për Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit për hedhjen poshtë të kërkesë në shumën maksimale prej 30 euro, sipas nenit 10.15 në lidhje me nenin 10.1 të UA 2008/20 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore.

Ankesa e B.V ka qar në anulimin e vendimit të KKKPK-së, si dhe në hedhjen poshtë të kërkesës së tij në AKP. Ankesa e B.V ka qenë pjesërisht e suksesshme. Në përputhje me nenin 452.2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme vendos që secila palë t'i marrë përsipër shpenzimet e veta. Prandaj, këto taksa gjyqësore do të merren përsipër nga B.V i cili ka paraqitur ankesë.

Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë për personin me vendbanim jashtë vendit është jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se B.V nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Udhëzim juridik**

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**